




Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës Jugore

Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



DATE/A:	13.11.2024
REFERENCE:	02-110/25-0374119/24
PËR/ZA/TO:	znj. Vesa BROJA – Kryesuese e Kuvendit të Komunës z. Bedri Hamza – Kryetar i Komunës
CC:	Anëtarët e kuvendit të komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Nazmi Jashari – Udhëheqës i Sekretarisë së Kuvendit
NGA/OD/FROM:	Znj. Drita Ibrahim – Kryetare e komisionit për hartimin e planit të veprimit për personat me aftësi të kufizuar 2025-2027
TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT:	Raport nga Konsultimi Publik për Planin e Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2025-2027

Hyrje

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020 e komunës së Mitrovicës Jugore, neni 14, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, të Rregullore (MAPL), Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës; neni 3 paragrafi 5, neni 6 dhe neni 7, paragrafi 1.3, të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2018 për Standartet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna dhe me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve tjera gjatë procesit të politikë bërjes dhe vendimarrjes në Kuvendin e Komunës së Mitrovicës Jugore, Grupi punës ka shpallur Konsultim Publik për Planin e Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar 2025-2027, për datë 24.10.2024, në sallën e kuvendit të komunës, duke filluar nga ora 14:00.

Ecuria e Procesit

Grupi punës në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2018 Për Standartet Minimale të Konsultimit Publik në komuna ka publikuar Njoftimin për Konsultim Publik të Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar në komunën e Mitrovicës së Jugut në ueb faqen e Komunës dy javë para mbajtjes së takimit në likun dhe në rrjetet sociale të komunës, po ashtu njoftimii është vendosur edhe në hyrje të objektit të komunës.

Njoftimi për konsultim publik është shpallur në afatin e paraparë ligjor, respektivisht neni 16 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2018 Për Standartet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, duke u interesuar që të sigurohet njoftimi i plotë dhe i duhur për palët e interesuara. Me ftesën për konsultim publik, palët e interesuara janë njoftuar me datën, vendin dhe kohën e mbajtjes së takimit publik. Njoftimit i është bashkëngjitur Plan i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2025-2027, që ka qenë objekt i konsultimit publik, shpjegime shtesë si dhe informata për personin përgjegjës për pranimin e komenteve.

Metoda e Konsultimit	Datat/Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/kontribuesve
1. Konsultimet me shkrim/në mënyrë elektronike	14 ditë	20
2. Publikimi në ueb faqe	14 ditë para mbajtjes së takimit kryesor	

Me planin e Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2025-2027 në komunën e Mitrovicës së Jugut, synohet të rregullohet mirëqenia psiko-sociale e personave me aftësi të kufizuara, përfshirja, punësimi etj duke krijuar interesin më të mirë për këtë grup të qytetarëve.

Pjesëmarrës në konsultimin publik ishin: grupi punues për hartimin e planit për PAK, Zyra për komunikim me Publikun dhe 20 pjesëmarrës.

Procesverbal nga Konsultimi Publik

20 pjesëmarrës të pranishëm

Drita Ibrahim – drejtore e mirëqenies sociale: theksoj rëndësinë e Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara për periudhën 2025-2027 në Mitrovicën e Jugut. Plan synon të sigurojë barazi dhe përfshirje për individët me aftësi të kufizuara, duke filluar nga familjet e tyre deri tek institucionet vendore. Në bashkëpunim me menaxherin e Qendrës së Down Syndrome Kosova, është bërë identifikimi i donatorëve për realizimin e këtij plani. Tutje, plani i veprimit për PAK është hartuar në mënyrë që të përfitojnë të gjithë personat me aftësi të kufizuara nga objektivat e caktuara.

Ju bëj thirrje për prindërit, familjarët dhe të gjithë ata që punojnë ngushtë me këta individë, të ofrojnë sugjerime dhe të ndajnë vështirësitë që hasin në përditshmërinë e tyre. Kjo do të ndihmojë në krijimin e zgjidhjeve efektive për nevojat e tyre. Në anën tjetër, komuna është e angazhuar në përmirësimin e kushteve për personat me aftësi të kufizuara, përmes subvencioneve, mundësive për punë praktike, rregullimit të infrastrukturës në shkolla dhe ofrimin të ndihmave të ndryshme. Këto nisma janë një hap i rëndësishëm drejt integritetit dhe mbështetjes së këtyre individëve në shoqëri.

Xhenis Beqiri: Menaxheri i Down Syndrome Kosova - Mitrovicë, ju falënderit për kohën dhe përkushtimin tuaj për hartimin e këtij dokumenti të rëndësishëm për komunitetin e aftësisë së kufizuar në Mitrovicë. Plani i veprimit është inicuar dhe hartuar nga Shoqata Down Syndrome Kosova, është mbështetur nga komuna e Mitrovicës, ndërsa financimi i aktiviteteve dhe hartimi i tij janë realizuar përmes fondeve të Bashkimit Evropian, konkretisht nga UNICER. Për të u kthyer në retropektivë, gjatë vitit të kaluar, janë mbajtur takime me përfaqësues të komunës dhe organizatave të shoqërisë civile që punojnë në fushën e aftësisë së kufizuar, të cilat kanë kontribuar në identifikimin e prioritetëve dhe hartimin e planit.

Plani i veprimit për PAK, përmbanë katër objektiva kryesore:

1. Përmirësimi i mirëqenies sociale dhe shërbimeve shëndetësore
2. Përmirësimi i gjithëpërfshirjes në jetën publike
3. Punësimi i personave me aftësi të kufizuara
4. Sigurimi i qasjes dhe lirisë së lëvizjes për këta individë

Këto objektiva janë të përcaktuara për periudhën 2025-2027 dhe do të kontribuojnë në përmirësimin e kushteve të jetesës për personat me aftësi të kufizuara në Mitrovicë. Aktiviteti i parë në kuadër të Planit të Veprimit synon përmirësimin e shërbimeve terapeutike dhe mbështetëse për personat me aftësi të kufizuara. Për realizimin e këtij qëllimi, pritet të kontraktohen organizatat e licencuara për ofrimin e shërbimeve për këtë grup të qytetarëve. Drejtoria e Mirëqenies Sociale do të jetë institucioni përgjegjës për implementimin e këtij aktiviteti.

Si aktiviteti i dytë, është parashikuar lirimi i personave me aftësi të kufizuara nga tatimi në pronë. Ky proces do të menaxhohet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës, e cila do të nxjerrë vendimin për librim nga tatimi për të gjithë individët në këtë kategori.

Aktiviteti i tretë përfshin sigurimin e vizitave në shtëpi nga specialisti i mjekësisë familjare për ata persona me aftësi të kufizuara që nuk kanë mundësi të realizojnë kontrollet mjekësore në Qendrën e Mjekësisë Familjare (QKMF). Drejtoria e Shëndetësisë do të jetë bartës i këtij aktiviteti.

Për më tepër, një tjetër aktivitet do të fokusohet në krijimin e kushteve të përshtatshme për punën e organizatave të shoqërisë civile që punojnë me personat me aftësi të kufizuara. Ky aktivitet do të realizohet përmes rregullimit të hapësirave të punës për këto organizata, me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës si bartës të këtij procesi.

Një aktivitet tjetër i rëndësishëm ka të bëjë me sigurimin e shërbimeve terapeutike për personat me aftësi të kufizuara, përmes mbulimit të shpenzimeve komunale për organizatat joqeveritare (OJQ) që ofrojnë këto shërbime. Në kuadër të shërbimeve komunale, parashikohet mbulimi i kostove për ujë, energji elektrike dhe tatime, duke marrë parasysh se organizatat e shoqërisë civile shpesh hasin vështirësi në përballimin e këtyre shpenzimeve. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës do të jetë bartës e këtij aktiviteti.

Për të ngritur vetëdijen e publikut dhe zyrtarëve mbi punësimin e personave me aftësi të kufizuara, është vendosur që Zyra e Kryetarit të marrë përsipër këtë aktivitet. Kjo do të përfshijë iniciimin e dhe shpalljen e konkurseve për punësimin e personave me aftësi të kufizuara në institucione.

Drejtoresha ekzekutive e **Handikos Mitrovica**, znj. **Myrvete Hasani**, theksoi se Spitali i Mitrovicës, veçanërisht repartin e fizioterapisë, ka kushte të mira për realizimin e terapi së fizikale. Megjithatë, ajo vuri në dukje se pritja për këto shërbime mund të arrijë deri në gjashtë muaj. Ajo propozoi organizimin e një takimi me spitalin, në mënyrë që disa nga terapi të fizikale të ofrohen drejtpërdrejt në repartin e fizioterapisë.

Gjithashtu, znj. Hasani theksoi rëndësinë e vizitave të vazhdueshme për personat me aftësi të kufizuara që jetojnë në zonat rurale dhe që kanë vështirësi për të realizuar kontrollat mjekësore në spitale. Këto masa janë të domosdoshme për të siguruar mbështetje dhe kujdes të vazhdueshëm për këtë kategori të rëndësishme të shoqërisë.

Znj. Drita Ibrahim, drejtore e mirëqenies sociale, theksoi se do t'i adresojë kërkesat e ngritura drejt Drejtorisë së Shëndetësisë dhe do të organizojë një takim për shqyrtimin e këtyre çështjeve.

Bekimi Ferati, kryetar i shoqatës së **Verbërve Mitrovicë** njoftoi se ekipa mjekësore ka realizuar tashmë vizita mjekësore në shtëpi për personat e verbër, duke kontribuar në përmirësimin e shërbimeve për këtë kategori.

Avni Kelmendi, Kryetar **OPFAKOS Mitrovicë**, shprehu shqetësimin e tij për pritjet e gjata në caktimin e termineve për terapi fizikale. Ai theksoi se, për shkak të numrit të madh të individëve që kërkojnë këto shërbime, pritjet për termine mund të zgjaten nga gjashtë muaj deri në një vit. Ai vlerësoi bashkëpunimin me Drejtorinë e Shëndetësisë, e cila ka realizuar kontrole të përgjithshme stomatologjike për të gjithë anëtarët e shoqatës, por gjithashtu theksoi koston e lartë të shërbimeve të ofruara. Tutje, ai kërkoi që komuna të gjejë një zgjidhje për transportin e personave me aftësi të kufizuara, qoftë për pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme apo për realizimin e kontrollave mjekësore. Sa i përket tatimit në pronë për personat me aftësi të kufizuara, ai sugjeroi që të shqyrtohet mundësia e krijimit të një autorizimi ose kompenzimi për familjet që kanë një anëtar me aftësi të kufizuara, në mënyrë që ato të lirohen nga ky tatim. Për më tepër, z. Kelmendi, theksoi vështirësitë që hasin në parkingun e Shtëpisë së Shëndetit dhe kërkoi nga zyrtarët policorë të rrisin vetëdijen lidhur me parkimin në vendet e rezervuara për personat me aftësi të kufizuara, duke siguruar që këto vende të mos zënë nga të tjerët. Këto masa janë të domosdoshme për të siguruar akses të lehtë dhe të barabartë për të gjithë individët me aftësi të kufizuara.

Koordinatorja gjeografike për Save the Children në Mitrovicë, Fahrije Kabashi, theksoi rëndësinë e kontraktimit të organizatave të licencuara për ofrimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara, me Drejtorinë e Mirëqenies Sociale (DMS) si bartëse të këtij aktiviteti. Ajo sugjeroi që përgjegjësia duhet të ndahet gjithashtu me Drejtorinë e Shëndetësisë (DSH), e cila ka filluar tashmë blerjen e disa shërbimeve për javën rozë. Një objektiv e ardhshme është krijimi

i një ekipi që do të ofrojë terapia fizikale për individët që nuk kanë mundësi të shkojnë fizikisht në spital, duke përfshirë edhe angazhimin e HANDIKOS-it për realizimin e këtyre shërbimeve.

Znj. Myrvete Hasani theksoi se Handikos Mitrovica, ka një fizioterapeut të mbështetur nga DSH, megjithatë, nuk ka kushte të mjaftueshme për të realizuar të gjitha terapitë e nevojshme për të gjithë anëtarët e shoqatës.

Elfije Kelmendi, psikologe në Handikos Mitrovica, kërkoi shqyrtimin e mundësive për lirin nga tatimi në pronë për personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre.

Xhenis Beqiri vazhdoi me prezantimin e aktiviteteve për përmirësimin e gjithëpërfshirjes në jetën publike. Aktiviteti i parë përfshin trajnimin e personelit mjekësor për identifikimin e hershëm të aftësisë së kufizuar, trajnime këto që do të realizohen nga DSH. Qëllimi është që mjekët të trajtohen si pika referuese për organizatat që punojnë me këtë grup të qytetarëve.

Fahrije Kabashi rekomandoi që në identifikimin e hershëm të personave me aftësi të kufizuara të përfshihet edhe Drejtoria Komunale të Arsimit, duke theksuar se identifikimi mund të bëhet edhe në institucionet parashkollore.

Xhenis Beqiri gjithashtu theksoi se aktualisht nuk ekziston një databazë që identifikon të gjithë personat me aftësi të kufizuara në komunën e Mitrovicës. Zyra për të Drejtat e Njeriut, në kuadër të Drejtorisë së Administratës Publike, do të punojë në krijimin e një databaze të tillë duke u bazuar në këtë plan të hartuar.

Aktiviteti i radhës do të përfshijë sigurimin e transportit për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, si dhe angazhimin e asistentëve dhe mësuesve mbështetës për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Drejtoria Komunale e Arsimit do të jetë përgjegjëse për këtë iniciativë.

Objektiva e tretë, që ka të bëjë me punësimin e personave me aftësi të kufizuara, është parapare inkurajimi i këtij grupi për të aplikuar në konkurse pune dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile për hartimin e kriterëve të punësimit. Kjo do të realizohet përmes Zyrës së Kryetarit dhe Zyrës së Personelit, duke inkurajuar gjithashtu anëtarët e OJQ-ve për regjistrim në qendrat regjionale për punësim. Për më tepër, do të krijohet një bashkëpunim me bizneset vendore për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, duke ofruar kushte të tilla si lirim nga tatimi për bizneset që punësojnë këta individë. Bartës i këtij aktiviteti do të jetë Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Zyra Regjionale e Punësimit.

Një tjetër aktivitet i rëndësishëm do të fokusohet në subvencionimin e ngritjes së kapaciteteve profesionale për personat me aftësi të kufizuara, me Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Departamentin për të Drejtat e Njeriut si bartës. Po ashtu, nga Zyra e Kryetarit do të kërkohet ngritja e vetëdijes së publikut dhe zyrtarëve për rëndësinë e punësimit të personave me aftësi të kufizuara.

Myrvete Hasani, theksoi se qëllimi kryesor është që personat me aftësi të kufizuara të mos perceptohen si pacientë, por si individë që jetojnë një jetë normale dhe kontribuojnë në shoqëri.

Xhenis Beqiri: Objektivat e fundit të Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara përfshijnë sigurimin e qasjes dhe lirisë së lëvizjes për këtë grup. Aktivitetet që pritet të

ndërmerren për realizimin e këtyre objektivave përfshijnë vlerësimin e objekteve publike për pengesat në qasje, një proces që do të udhëhiqet nga Drejtoria e Urbanizmit.

Po ashtu, është paraparë rregullimi i qasjes në objektet publike nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës, si dhe realizimi i rregullimeve të nevojshme (rampat, dyert, tualetet dhe transporti urban) në shkollat fillore dhe të mesme, nga DSHPI dhe DKA.

Një tjetër iniciativë është shtimi i numrit të parkingjeve për personat me aftësi të kufizuara dhe lirimi i parkingjeve të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara, me Drejtoratin e Urbanizmit si bartës të këtij aktiviteti, si dhe vendosja e sinjalistikës akustike në udhëkryqe nga DSHPI.

Bekimi Ferati, theksoi se përveç mungesës së semaforëve akustikë për personat e verbër, gjithashtu mungon ecja e shkopit në brilla, një nevojë e rëndësishme për sigurinë e këtyre individëve.

Avni Kelmendi, sugjeroi që, gjatë pranim-nderhyrjeve për ndërtimin e shkollave nga Drejtoria e Urbanizmit, të kërkohet përfshirja e elementeve që lehtësojnë hyrjen dhe daljen e personave me aftësi të kufizuara.

Myrvete Hasani, kërkoi që këto sugjerime të shqyrtohen gjithashtu në ndërtimin e ndërtesave, duke u siguruar që të krijohet një pjerrinë më e përshtatshme dhe që dritat të vendosen në një lartësi të caktuar dhe të përshtatshme për nevojat e personave me aftësi të kufizuara.

Xhenis Beqiri: Të gjitha komentet dhe sugjerimet e dhëna do të inkorporohen në Planin e Veprimit, i cili do të përditësohet dhe shpërndahet me të gjithë pjesëmarrësit në takim. Këto nisma janë thelbësore për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe integrimin e plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri.

Drita Ibrahim: Plani i veprimit pas inkorporimit të komenteve, do të prezantohet në Asambleen Komunale për votim, në muajin nëntor, 2024.

Xhenis Beqiri: Falemnderit për pjesëmarrjen dhe angazhimin tuaj në përmirësimin e mirëqenies sociale.

.....
Më datë 5.11.2024 është pranuar email zyrtar nga Demokracia + OJQ nga Prishtina e cila ka ofruar disa rekomandime për përfshirjen e tyre në planin e veprimit PAK;

Objektiva e parë: Përmirësimi i mirëqenies sociale dhe shërbimeve shëndetësore

Rekomandojmë të përmendet krijimi i një sistemi mbikëqyrës dhe raportues. Të mbahen takime periodike vjetore për vlerësimin e progresit, me përfshirjen e të gjitha palëve të interesit. Një raport publik që pasqyron progresin dhe sfidat do të siguronte transparencë dhe do të ndihmonte në identifikimin e fushave që kanë nevojë për përmirësim. – *Aktiviteti është përfshirë*

Rekomandojmë që të formoni një këshill të përhershëm për PAK, që përfshin përfaqësues nga grupe të ndryshme të komunitetit, për të siguruar që zëri i tyre merret parasysh në vendimmarrje dhe në zbatimin e politikave. – *aktiviteti tashmë gjen zbatim*

Të kjo pjesë e aktiviteteve rekomandojmë të shtohet ky aktivitet: Organizimi i një fushate ndërgjegjësimi që informon qytetarët dhe PAK për të drejtat e tyre, shërbimet që kanë në dispozicion dhe mundësitë për mbështetje institucionale. Si indikator për këtë aktivitet të shtohet: Numri i fushatave të realizuara dhe % e qytetarëve të informuar për shërbimet për PAK. – *aktiviteti është përfshirë*

Rekomandojmë që disa indikatorë të formulohen në atë mënyrë që të jenë të bazuar në rezultate. Fokusi të jetë në indikatorë që matin ndikimin dhe rezultatet konkrete për mirëqenien dhe përfshirjen e PAK. Për shembull, në vend të vetëm "numrit të vizitave", matni gjithashtu "përmirësimin e cilësisë së jetës së familjeve të PAK pas vizitave". Shtoni anketime për të vlerësuar se sa janë të kënaqur PAK dhe familjet e tyre me shërbimet dhe aktivitetet. Kjo tregon nëse indikatorët po arrijnë qëllimin e tyre. Të rishikohen indikatorët çdo vit për tu siguruar që ato përputhen me objektivat dhe nevojat aktuale të PAK. Ky indikator të formulohet në atë mënyrë që shërben për të matur edhe ndikimin e vizitave në përmirësimin e mirëqenies së PAK. Rekomandojmë këtë formulim për këtë indikator: Numri i familjeve të vizituara dhe % e familjeve që raportojnë përmirësim në mirëqenie pas vizitave. – *aktiviteti është përfshirë poashtu dhe indikatorët e propozuar*

Përveç kontraktimit, sugjerojmë të bëhet një monitorim periodik i cilësisë së shërbimeve të ofruara nga këto organizata për të garantuar që janë në përputhje me standardet. Gjithashtu, përfshini një indikator që mat kënaqësinë e PAK nga këto shërbime. – *aktiviteti është përfshirë*

Objektiva e dytë: **Përmirësimi i gjithëpërfshirjes në jetën publike**

Këtu rekomandojmë të shtohet ky aktivitet: Fushata vetëdijësuese për të ndryshuar perceptimet e komunitetit rreth personave me aftësi të kufizuara dhe për të promovuar përfshirjen e plotë të PAK në jetën sociale, kulturore dhe ekonomike. – *aktiviteti është përfshirë*

Me qëllim për të iu mundësuar PAK pjesëmarrje të drejtpërdrejtë dhe ndikim në politikat dhe vendimet që ndikojnë në jetën e tyre, rekomandojmë të kjo pjesë të shtohet ky aktivitet: Formimi i një këshilli për PAK që do të bashkëpunojë me komunën në hartimin dhe vlerësimin e politikave dhe planeve për këtë kategori. Si indikator për këtë aktivitet është: Numri i takimeve të këshillit dhe numri i rekomandimeve të propozuara dhe të implementuara. – *aktiviteti dhe indikatorët e propozuar janë përfshirë*

Për këtë aktiviteti Punësimi i asistentëve – Profili asistent/e për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, D+, ka propozuar: Në vend të një numri fiks asistentësh për shkollë, do të ishte më mirë të vlerësohen paraprakisht nevojat e secilit nxënës me aftësi të kufizuara për të përcaktuar numrin dhe llojin e asistencës që i duhet. Kjo do të ndihmojë në caktimin e asistentëve në mënyrë të drejtë dhe efektive, duke reduktuar mundësinë e mbingarkesës për një asistent. Një rekomandim konkret për vendosjen e numrit të asistentëve mund të ishte raporti **1 asistent për 1-3 nxënës** (në varësi të nevojave të tyre). Nëse një nxënës ka nevoja më intensive, një asistent i caktuar për të mund të jetë i domosdoshëm. Për nxënës me nevoja më të lehta, një asistent mund të kujdeset për 2-3 nxënës. – *sugjerimi është përfshirë pjesërisht*.

Objektiva e tretë: **Punësimi i personave me aftësi të kufizuara**

Rekomandojmë këtë aktivitet të kjo pjesë: Krijimi i programeve të praktikave profesionale me pagesë në bashkëpunim me institucionet publike dhe bizneset lokale për të ofruar mundësi punësimi afatshkurtra dhe përvojë pune për PAK. Tregues për këtë aktivitet do të ishte: Numri i PAK të përfshirë në programe praktike dhe numri i vendëve të punës të krijuara pas përfundimit të praktikës. – *aktiviteti është përfshirë poashtu dhe indikatorët*

Përveç inkurajimit, zhvilloni trajnime për zhvillimin e aftësive për kërkimin e punës, intervistat etj., për të ndihmuar PAK në procesin e aplikimit dhe përgatitjes për tregun e punës. *Pjesërisht janë përfshirë*

Për të matur efektin e publikimeve shtoni këtu edhe këtë indikator: Numri i aplikimeve nga PAK në konkurse të punës pas publikimeve. – *janë përfshirë këta indikatorë*

Ti kushtohet rëndësi informimit të komunitetit të biznesit rreth beneficioneve financiare në punësimin e PAK. Rekomandojmë të shtohet këtu: Hartimi dhe shpërndarja e udhëzuesve për punësimin e PAK për bizneset, që përfshinë informata rreth lehtësive, përfitimeve, dhe përgatitjes së vendeve të punës për PAK. Për indikator: Numri i udhëzuesve të shpërndarë. – *janë përfshirë*

Objektiva e katërt: Sigurimi i qasjes dhe lirisë së lëvizjes për personat me aftësi të kufizuara

Në fund të kësaj pjese/objektive rekomandojmë të shtohet ky aktivitet: Krijimi i një mekanizmi monitorimi që inspekton/shqyrton vazhdimisht gjendjen e objekteve publike dhe të sigurojë që ato janë të përshtatshme për qasje nga PAK. Treguesi për këtë: Numri i inspektimeve të realizuara dhe % e ndërhyrjeve për përmirësimin e qasjes të raportuara çdo vit. *Janë përfshirë*

Me qëllim për të rritur pavarësinë e personave me aftësi të kufizuara dhe për të ndihmuar në përfshirjen e tyre në shoqëri, duke ndjekur praktikën më të mirë të vendeve tjera, sugjerojmë të shtohet këtu ky aktivitet: Programe të dedikuara për aftësitë e jetës së pavarur të PAK, siç janë kurse për orientimin në hapësirat publike dhe përdorimin e transportit publik. – *është përfshirë rekomandimi*

Për këtë aktivitet D+ ka rekomanduar Vendorsja e sinjalistikës akustike në udhëkryqe. – *është përfshirë.*


Për këtë aktivitet D+ Vendorsja e pllakave në trotuare për mundësim të lëvizjes së lirë për personat e verbër, Ky aktivitet rekomandojmë të formulohet kështu: Vendorsja e pllakave taktile në trotuare për të mundësuar lëvizjen e lirë dhe orientimin e personave të verbër. *Është përfshirë.*

Grupi punues e ka miratuar unanimisht planin e veprimit për PAK duke i përfshirë komentet dhe sugjerimet e pjesëmarrësve.

Lista e pjesëmarrësve – Konsultimi Publik mbi Planin e veprimt për PAK

Data: 24/10/2024

Qendra: Mitrovicë

Nr.	Emri dhe mbiemri	Pozita e punës	Institucioni	Kontakti – Nr. i tel	E-mail	Nënskrimi
1	Drift Ibrahim	Dejtoni Ismail Kryetar i Sektorit DMJ	Komuna Kuvendi e Jugut	045-248258	drift.r.ibrahim@ dmj-gov.net	
2	Nexhat Ruzhiti	Dejtoni Ismail Kryetar i Sektorit DMJ	Komuna Kuvendi e Jugut	044 1147 669	nexhat.ruzhiti@vks-gov.net	Nexhat Ruzhiti
3	Arsim Dorzi	Zyrtar Policor	Policia	049-490-059	arsim.dorzi@kuvend.gov.net	
4	Arjetta Zylykbashi	Zyrtar Policor	Policia	059-589-809	arjetta.zylykbashi@kuvend.gov.net	Arjetta Zylykbashi
5	Fahrije Kabashi	Kryetare Gjeografike	SCIK	044 118 117	fahrije.kabashi@kuvend.gov.net	Fahrije Kabashi
6	Kuljeta Hazi	Pedagog	SHENJA Skendrra	044 744 665	kuljeta.hazi@kuvend.gov.net	Kuljeta Hazi
7	Hanemzade Sadika	Nenë		045 966 076		Hanemzade Sadika
8	Sofije Adem	Nenë		044 2929 83		Sofije Adem
9	Shefrije Abiti	Nenë		045 452 063		Shefrije Abiti
10	Fatmir Hyseu	Bozori		044-875-225		Fatmir Hyseu
11	Arif Kelmendi	Kryetar	OPAKKOJ	049-495-721	arif.kelmendi@kuvend.gov.net	Arif Kelmendi

12	Shkurta	Ademi	DSK	-	-	Sh.A
13	Albina	Abitei	DSK	-	-	A.A
14	Beini Mejdini	.	DSK	-	-	B.H
15	Egzona	Iqirishita	DSK	049-896-226	egzona.iqirishita@bst.com	BE
16	Edita	Bikalli	DSK	049-849-682	edita.bikalli@bst.com	BE
17	ELFIDE KESHENI	PSIKOLOGE	HANALIOS	049347246	elfidekesheni@bst.com	BE
18	MYRENE JHANA	PSIKOLOGE	HANALIOS	049-849-798	-	BE
19	Belum (Fendi)	Anjta	Shkurti	044 585869	-	B.F
20	Xhenis Beqisi	Stenajher qenajher	DSK	049 883053	Xhenis.beqisi@bst.com	Stenajher
21						
22						
23						
24						
25						
26						
27						
28						
29						
30						